



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nr. 896 Prot.

Tiranë, më 09.10 2023

Lënda: Mbi shpalljen e kritereve, tarifave dhe kuotave për ciklin III, doktoratë në “Muzikologji”

**Zv.Rektor i Universitetit të Arteve
Prof. Dr. Erald Bakalli**

I nderuar Z. Zv.Rektor

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit Nr. 128, datë 16.03.2022 *Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Muzikologji”, në Universitetin e Arteve Tiranë, dhe në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji, Neni 15, Pika 2, po ju përcjellim shkresën e Njësia Bazë KMDP.*

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin e vazhdueshëm.

Me konsideratë,

Prof. Dr. Isak SHEHU



DEKAN I FM-së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 06.10.2023

Lënda: Mbi shpalljen e kriterëve, tarifave dhe kuotave për ciklin III, doktoratë në “Muzikologji”

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Muzikës
Prof. Dr. Isak Shehu

Këtu

I nderuar Z. Dekan

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit Nr. 128, datë 16.03.2022 *Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Muzikologji, në Universitetin e Arteve Tiranë, shkresën e MAS Nr. 1870/3, datë 24.04.2023 Mbi listën e udhëheqësve shkencorë në programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 dhe në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji, Neni 15, Pika 2, e ndryshuar, miratuar me VSA Nr. 43, datë 28.09.2023, po ju parashtrojmë kriteret, kuotat dhe tarifat për ciklin III Doktoratë në “Muzikologji” si më poshtë:*

1. Studimet në Ciklin III për fitimin e gradës shkencore “Doktor” do të zhvillohen pranë Njesisë Bazë KMDP në fushën e Muzikologjisë për projektin kërkimor “**Muzika shqiptare në epokën e post-modernzimit (1990-2020)**” dhe “**Muzika në shoqërinë shqiptare**”. Kandidatët mund të paraqesin kërkesat e tyre vetëm për tema që lidhen me projektet kërkimor të sipërpërmendura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP

2. Kohëzgjatja e punës kërkimore është minimalisht 3 vite akademike dhe jo më shumë se 5 vite akademike e strukturuar si më poshtë:

Veprimtaritë e kryera në kuadër të doktoratës	Viti I	Viti II	Viti III
Pjesëmarrje në Forumin i Doktoratës	<i>Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës</i>	<i>Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës</i>	<i>Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës</i>
Paraqitje përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesshme	<i>Prezantim i detajuar i projektit kërkimor.</i>	<i>Prezantim i punës kërkimore dhe rezultateve të arritura</i>	<i>Paraqitja e fundit e punës kërkimore.</i>
1) Realizimi i të paktën tre referimeve në veprimtari shkencore (simpoziume, konferenca, kongrese). 2) Botimi i të paktën tre artikujve shkencorë në revista shkencore.			

3. Aplikimet në programin e Doktoratës do të pranohen nga kandidatët që plotësojnë kriteret si më poshtë vijon:
- a. Të zotërojnë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në Muzikologji, Kompozim, Dirizhim ose në fusha të përafërta. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi. Për tu pranuar në programin e Doktoratës kandidatët kanë detyrimin që të zotërojnë diplomë të ciklit të parë dhe diplomë të ciklit të dytë, sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, në fusha të ngjashme/të përafërta.
- b. Kandidatët që zotërojnë diplomë, sipas përcaktimeve më sipër, në fusha të përafërta, vlerësohen bazuar në përputhshmërinë e lëndëve dhe programeve të Curriculës së tyre (Bachelor dhe Master) me ato të Curriculës së programit të njëjtë (Bachelor dhe Master) që paraprin programin e studimeve të Doktoratës.
- c. Të dëshmojnë njohuritë në një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP

programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, ndryshuar me Udhëzimin e Mas nr. 10, datë 16.06.2023. Nëse kandidati zotëron një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

- d. Në studimet e Doktoratës do të pranohen vetëm kandidatët të cilët, në studimet Master i Arteve ose Master i Shkencave (ose në diplomën e sistemit 4 vjeçar) mesataren e ponderuar e kanë më të lartë ose të barabartë me 8.
4. Të drejtën për tu regjistruar në konkursin e pranimit për studimet e doktoratës e kanë edhe kandidatët me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë kufirit të RSH sikurse dhe shtetasit e tjerë të huaj që plotësojnë kushtet e mësipërme (këta të fundit duhet të dëshmojnë, me dokumentacionin përkatës, njohjen e gjuhës shqipe konform ligjeve në fuqi).
5. Konkurrimi bëhet me dosje e cila dorëzuar pranë Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës brenda **datës 3 Nëntor 2023 ora 14:00**.
6. Dosja e kandidatit duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Certifikata e lindjes (origjinal);
 - b) Çertifikata e martesës apo dokument tjetër i ndryshimit të mbiemrit, nëse ka (kopje e noterizuar);
 - c) Kopje e noterizuar e Supplementit të Diplomës Bachelor ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlershëm në MAS;
 - d) Kopje e noterizuar Listës së notave dhe Krediteve në Studimet Bachelor ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS;
 - e) Kopje e noterizuar e Supplementit të Diplomës Bachelor ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlershëm në MAS;
 - f) Kopje e noterizuar të Diplomës Master ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlershëm në MAS;
 - g) Kopje e noterizuar të Listës së notave dhe Krediteve të Diplomës Master ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlershëm në MAS;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP

- h) Kopje e noterizuar e Supplementit të Diplomës Master ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlershëm në MAS;
 - i) Kopje të noterizuara të studimeve Pas-Master, programeve të ndryshme të formimit të vazhduar etj. të kryera brenda dhe jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti/at është/janë njohur si i/të barasvlershëm në MAS;
 - j) Kopje e pasaportës (për qytetarët e huaj);
 - k) CV-ja e veprimtarisë shkencore/artistike;
 - l) Dosjen me dokumente që vërtetojnë CV-në;
 - m) Kopje e noterizuar e Dëshmisë së Gjuhës së huaj sipas kërkesave standart të MAS;
 - n) Synopsis i Temës së propozuar të Disertacionit dhe programin për të cilin konkuron;
 - o) Bibliografia, e pjesshme, që do të përdoret për Temën e propozuar;
 - p) Propozimi për Udhëheqësin e Temës së Disertacionit prej listës së miratuar në UART;
 - q) Miratimi i Udhëheqësit të propozuar të Disertacionit;
 - r) Formulari i Regjistrimit;
 - s) Mandat pagesa e Regjistrimit në shumën 5,000 ALL;
 - t) Deklaratë që Kandidati nuk ka qenë më përpara pjesë e një programi studimor në doktoratë në të cilën është vlerësuar negativisht;
 - u) Dy rekomandime nga pedagogë të kategorisë që kanë së paku gradën “Doktor” ose i përkasin kategorisë “Profesor”;
7. Vlerësimi maksimal i kandidatit është 100 pikë. Minimumi i pikëve të grumbulluara për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë “Doktor” në Muzikologji është 40 pikë.
8. Tarifa e ndjekjes ndjekjes së studimeve në programin e ciklit III “Doktor në Muzikologji është në shumën 500,400 ALL.
9. Në vitin akademik 2023-2024 do të pranohen në total **25** kandidatë të cilët mund të zgjedhin për tu udhëhequr në veprimtarinë e tyre kërkimore për fitimin e gradës shkencore “Doktor në Muzikologji, një nga pedagogët e poshtëshënuar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik	Numri i Udhëheqjeve për vitin akademik 2023-2024
1	Zana Shuteriqi	Profesor	2
2	Isak Shehu	Profesor	2
3	Fatmir Hysi	Profesor	2
4	Vaso Tole	Akademik	2
5	Ilirjana Dema	Profesor	2
6	Sokol Saraçi	Profesor i Asociuar	1
7	Kastriot Tusha	Profesor i Asociuar	1
8	Endri Sina	Profesor	1
9	Nestor Kraja	Profesor i Asociuar	1
10	Bujar Sykja	Profesor	1
11	Dorina Laro	Profesor i Asociuar	1
12	Merita Rexha	Profesor i Asociuar	1
13	Arbana Fejzo	Profesor i Asociuar	1
14	Kristina Laço	Profesor i Asociuar	1
15	Elvis Rudi	Profesor i Asociuar	1
16	Lorenc Radovani	Profesor	1
17	Arian Paço	Profesor	1
18	Arben Llozi	Profesor	1
19	Petrika Afezolli	Profesor	1
20	Mirela Sykja	Profesor i Asociuar	1

Për më shumë informacion kandidatët ftohen të konsultojnë rregulloren e programit të doktoratës në linkun <http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=569&niveli=105>.

Përgjegjës i Njesisë Bazë KMDP


Prof. Asoc. Dorian Çene

